J.D: Po. Në fillim, nga 7 maji, Departamenti Special i Auditimit pranë Administratës Tatimore mori një kërkesë nga Njësia e Hetimit Financiar (NJHF) e EULEX-it lidhur me kompanitë e cekura, Petranol, me numër regjistrimi 70346294, dhe Kompania Leotrimi, me numër regjistrimi 70047129. Kërkesa kishte të bënte me faktin nëse biznesi MTP Petrol-Nol e kishte deklaruar shumën prej 1,616,649.40 eurosh e cila ishte debituar në llogarinë bankare të MTP Petrol-Nol dhe se shuma prej 1,614,120 eurosh u ishte transferuar kompanive të ndryshme jashtë vendit....

Administrata Tatimore i ka vlerësuar bazuar në Ligjin 2004/48 dhe në nenin 15. Çdo person i cili sipas legjislacionit ka për detyrë të deklarojë taksat, duhet t'i paraqesë Administratës Tatimore të Kosovës ose agjentit të tij, në këtë rast Banka Tregtare, deklaratën përkatëse të kërkuar me ligj.

Subjekti në fjalë, Petrol-Nol, nuk i ka paraqitur asnjë lloj deklarate Administratës Tatimore të Kosovës. Bazuar në nenin 17, “informacioni i siguruar nga një person në deklaratën tatimore të tij ata nuk e paraqesin në mënyrë të rregullt detyrimin tatimore të tij ose kur taksapaguesi nuk e ka paraqitur deklaratën e tij në atë kohë prandaj Drejtori mund të bëjë vlerësim sipas detyrës profesionale të tij. Vlerësimi do të ishte sipas gjykimit të tij dhe në aftësinë më të mirë të tij duke u bazuar në libra, burime dhe prova të ndryshme.”

Petrol-Nol nuk paraqiti asnjë lloj deklarate dhe nuk pagoi tatim.

Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë vlerësim të tatimit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe të tatimit mbi të ardhurat personale për vitin 2006....

Prokurori publik: ...Kam një pyetje, meqë në llogarinë e Kompanisë Petro-Nol është kredituar më shumë se 1,600,000 euro; a e di dëshmitari nga cili u debitua kjo shumë në këtë llogari?

J.D: Taksapaguesi Petro-Nol kishte hapur llogari bankare në Prishtinë në Bankën NLB. Numri i xhirollogarisë së tyre është 1703200003068893.

Nga kjo xhirollogari jashtë shtetit janë transferuar shumat që cekëm. Këto para u depozituan dhe transferuan jashtë vendit tek Kompani Bonus në Mal të Zi dhe kjo ishte pagesë për lëndën djegëse, Frema Tobacco International nga Qipro dhe ishte pagesë për lëndë djegëse dhe për Kurnell Business Corporation nga SHBA si pagesë për detergjent pluhur për larje.

Prandaj bazuar në këto shkresa që kishim, u përpoqëm të kontaktojmë me taksapaguesin për të marrë tatimin për këtë shumë parash.

Meqë nuk arritëm t'i kontaktojmë dhe bazuar në nenin 17, Administrata e Tatimeve ka bërë një vlerësim të tatimit të detyrueshëm për t'u paguar....

Petro-Nol merrej me lëndë djegëse dhe produkte

Meqë kompania Petro-Nol nuk e ushtroi të drejtën e saj për ankesë dhe bazuar në afatin ligjor prej 60 ditësh, Administrata Tatimore filloi hapat e tjerë për të gjetur taksapaguesin dhe për t'i dorëzuar atij formularët e llogaritjes së tatimit. Kjo doli e pamundur dhe ne nuk arritëm t'i kontaktojmë.

Prokurori publik: Përmendët më herët librat dhe faturat tatimore. A i posedon Administrata Tatimore këto prova?

J.D: Jo.

Prokurori publik: A mund të na tregoni se bazuar në çfarë informacioni u llogaritën tatimet?

J.D: Bazuar në informacionin e marrë nga palët e treta, NJHF e EULEX-it

J.D: Mungesa e kontaktit me tatimpaguesin e ka detyruar Administratën Tatimore ta bëjë vlerësimin e tatimit nga zyra dhe bazuar në informacionin që kishim në posedim.

Prokurori publik: E njëjta pyetje lidhur me kompaninë "Leotrimi"?...

J.D: 460,748.44 euro.

Rexhep Hasani: ... Unë nuk e kuptova çfarë i bëri ato transaksione?

J.D: Shuma që ceket tani u depozitua në një llogari në Casa Bank dhe e njëjta shumë u transferua në subjektet që u cekën më lart.

Rexhep Hasani: Kush i depozitoi ato?

J.D: Mbajtësi i llogarisë është Petro-Nol me pronare R.On.

Rexhep Hasani: A keni ndonjë shkresë që të provojë se ato para i depozitoi R.O?

J.D: Jo, asnjë provë tjetër përveç shkresave të bankës....

Rexhep Hasani: Kush e bëri këtë vlerësim?

J.D: Administrata Tatimore e Kosovës....

Haxhi Millaku: G.V dhe gruaja e tij M.V, F.V si pronarë të MTP Kompanisë Ngas, Kompanisë Shkoza dhe unë mund të shoh se disa transfertat iu bënë disa kompanive si YugoPetrol. Në pjesën ku përmenden Kompanitë Petro Nol dhe Leotrimi, a e patë emrin e G.Vt, M.Vt ose F.Vt?

J.D: Këto janë subjekte të ndryshme. Më 28 dhjetor 2004, Administrata Tatimore i bëri kontroll auditimi taksapaguesit Kompania Leotrimi....

....

J.D: Vlerësimi për Petro-Nol është bërë bazuar në transfertat bankare. Për taksapaguesin Leotrimi është bazuar në importet e kryera nga ky subjekt duke filluar nga 25 tetori 2003 deri më 6 prill 2004.

Haxhi Millaku: A keni emrin e ndonjë personi që i ka kryer këto transaksione?

J.D: Po. Kompania Leotrimi me numër biznesi 70047129 me pronar G.Rn me banues në Prizren...

Haxhi Millaku: Ka një konkluzion të bërë nga Shërbimi Policor i Kosovës, dorëzuar Autoriteteve ku tregohet një shumë e madhe parash të depozituara në llogari bankare. Unë nuk e kam hasur kurrë emrin e G.Rt në dokumentet që ju janë dhënë juve....

....

Haxhi Millaku: Ju po na jepni statistikën e mallrave që hynë në vend. A i keni dokumentet DUD për mallrat e importuara?

J.D: Po, i kemi të gjitha shkresat DUD.

Haxhi Millaku: A mund t'i kërkoj dëshmitarët të na japë shkresat DUD sepse ato do të vërtetohin çështjen e mallrave të importuara në vend dhe në këto shkresa do të shiheshin lëvizje të veçanta.

Kryetarja e trupit gjykues: Gjykata do të kërkojë shkresa të tjera po të jetë e nevojshme.....

.....

J.D: ... çdo lloj importi që hyn në vend na raportohet neve përmes shkresave.

Haxhi Millaku: Ju keni kontaktuar edhe me pikat kufitare, doganat e Malit të Zi?

J.D: Jo ne.

Haxhi Millaku: A dini nëse këto pika i ka kontaktuar EULEX?

J.D: Po.

Haxhi Millaku: Kam një kërkesë për trupin gjykues, të kontrollojë çdo import të veçantë që është bërë nga Kompania Leotrimi ku të shohim se kush ishte personi i autorizuar. Kjo mund të na tregojë gjithashtu se kush i keqpërdori dokumentet e Kompanisë Leotrimi dhe kush e ka sjellë këtë kompani në këtë fazë.

2. G.V

Ai deklaroi se është ekonomist me arsimim dhe kishte një kompani private që merrej me shërbime doganore në kufirin afër Pejës.

Ai ishte personi i autorizuar për kompaninë Leotrimi dhe Petro-Nol gjatë periudhave të përfshira në Aktakuzë.

Ai nuk i dha gjykatës ndonjë provë se të pandehurit ishin kryerësit e veprave që u viheshin në barrë në Aktakuzë.

Nga ana tjetër, gjykata pati përshtypjen se në lidhje me deklaratat e gruas dhe vëllait të tij të bëra më vonë në të njëjtën seancë se ai është afarist inteligjent që përpiqet t'i lërë të tjerët të bëjnë atë që dëshiron ai duke i përdorur si marioneta në biznesin e tij, si gruan dhe vëllain e tij të cilët deklaruan se ata nuk kishin fare ide për kompaninë që kishin hapur dhe për të cilën ata e autorizuan atë dhe se është ai që punon duke përdorur kompaninë e tyre.

Duke pasur në mendje këtë kontekst, gjykata gjen se sidoqoftë ai nuk do të kishte qenë personi i duhur i besueshëm që do t'ua hidhte fajin të pandehurve.

Pjesët më të rëndësishme të dëshmisë së tij janë si vijon (proces-verbali i datës 24.10.2012, faqe 2-16):

“Prokurori publik: Mësuam se ju kishit një biznes, a ishte ai privat?”

G.V: Po.

Prokurori publik: Si quhej?

G.V: Shkoza.

G.V: Për momentin nuk merret me tregti; më parë ishte shërbime dhe me çështjet doganore ekskluzivisht.

Prokurori publik: Çfarë shërbimesh?

G.V: Doganore.

Prokurori publik: A mund ta shpjegoni në hollësi ju lutem?

G.V: Kur biznesi u regjistrua në doganë në vitin 2000 ishte agjenci doganore.

Prokurori publik: Çfarë do të thotë kjo?

G.V: Si jeni ju jurist me profesion, ne jemi ndërmjetës të shërbimeve ndërmjet importuesve dhe doganave.

Prokurori publik: A keni dëgjuar ndonjëherë për kompaninë Leotrimi?

G.V: Më kujton diçka por kohë përpara.

Prokurori publik: Po për NT Petro-Nol?

G.V: Jo.

Prokurori publik: A e njihni G.Rn?

G.V: Po.

Prokurori publik: R.On?

G.V: Po.

....

Prokurori publik: Si i njihni?

G.V: ... u njohëm me njëri tjetri përmes doganës nga dikush, nuk më kujtohet.

....

G.V: nuk kishim ndonjë marrëveshje tjetër me të përveç atyre private. Unë nuk kisha marrëdhënie zyrtare me të, vetëm private.

Prokurori publik: Cila është procedura për doganat, çfarë ju japin ato dhe çfarë u ktheni juve?

G.V: Fillimisht procedurë progresive; të themi, erdhën mallra në doganë dhe me shkresat ai shkon tek doGaeri për të kryer procedurat doganore, ku ne u kërkonim 10, 20 ose 30 DM, në varësi të rastit, për t'i bërë punën me shkresat. Kur përfundonte procedura doganore, dokumentet i jepen klientit dhe ai shkon. Pas kësaj ne nuk kemi më përgjegjësi.

Prokurori publik: Pra, mallrat vinë në pikën doganore; çfarë ju jep transportuesi nëse pronari nuk është atje?

G.V: Të gjithë dokumentacionin, fatura, dokumentet ndërkombëtare të quajtura CMR; në shqipe është urdhër pagese.

Prokurori publik: Çfarë bëni pasi të keni marrë dokumentet?

G.V: Bazuar në dokumentet, unë përgatis deklaraten unike për doganën, DUD, dhe pastaj ajo u dorëzohet organeve zyrtare brenda doganës.

Prokurori publik: Doganën atje apo në terminal?

G.V: Ajo është e veçantë në doganën e Pejës; kjo ka të bëjë me gjeografinë e saj. Pika e hyrjes është pak larg nga pika doganore. Të gjitha dokumentet personale të automjetit mbahen dhe merren në pikën e hyrjes dhe udhëzimi me numrin e protokollit dhe numri i referencës i jepen vozitësit për të shkuar në doganë. Një kopje mbahet nga vozitësi dhe kur ne përpilojmë dokumentin ai përputhet me dokumentacionin në pikën e hyrjes.

Prokurori publik: Pra, ju merrni të gjithë dokumentacionin dhe bënin punën doganore; çfarë bëni me dokumentet?

G.V: Dogana bën një kontroll tjetër për të parë nëse të gjitha dokumentet janë të plota dhe nëse mundon ndonjë gjë ose nëse ka ndonjë mangësi...

....

G.V: Të gjitha dokumentet dorëzohen dhe agjentët e doganës kontrollojnë mallin. Ndonjëherë ata bëjnë vlerësimin e tyre dhe mund të mos e pranojnë vlerën e deklaruar në faturë. Me t'u zgjidhur kjo bëhet pagesa dhe dokumentet merren nga ne dhe i jepen vozitësit i cili pastaj bën pagesën tek porta. Ne nuk kemi përgjegjësi për këtë. Pastaj vozitësi largohet.

....

Prokurori publik: A ju kujtohet çfarë importonte R.O dhe G.R?

G.V: Nuk më kujtohet. Kishte kaq shumë klientë sa që do të ishte e pamundur të dija çfarë importohej.

.... *Prokurori publik: A ju kujtohet nëse i keni takuar R.On dhe G.Rn ose të dy?*

G.V: G.Rn po, por R.On shumë pak herë.

....

Prokurori publik: A ka ndodhur të keni kryer ndonjë transfertë për NT Leotrimi dhe NT Petrol-Nol?

G.V: Mund të ketë ndodhur për NT Leotrimi por për NT Petrol-Nol s'ka mundësi. Fillimisht çdo gjë bëhej në kasë, domethënë, pagesat për mallrat dhe nuk kishte sisteme sepse kështu punonin institucionet. Megjithatë, me përfshirjen e bankave, shumica dërrmuese e klientëve na autorizonin ne të bënim pagesat përmes bankës në emër të tyre në lidhje me mallrat në doganë.

Prokurori publik: Do të dëshiroja t'i tregoj dëshmitarit një deklaratë financiare të nënshkruar në emër të NT Leotrimi.

G.V: Ju lutem lexojeni.

Prokurori publik: Një dokument i datës 2 prill 2004 përmes bankës për biznesin dhe klientin NT Leotrimi ku u transferua shuma prej 6,500 eurosh. Nuk e di se ku u transferua. Ajo u transferua nga NT Leotrimi dhe ishte nënshkruar nga G.V.

....

G.V: Aty deklarohet 'personi i autorizuar' dhe se kjo ishte në para fizike. Mund të konfirmoj tani se duhet të kem qenë unë personi i autorizuar, përndryshe banka nuk do ta lejonte këtë....

....

Prokurori publik: A kishit autorizim për të nënshkruar për NT Leotrimi?

G.V: Duhet ta kem pasur, siç bëja për shumicën e klientëve të mi.

Prokurori publik: Përsëri me lejen e gjyqtarës, dëshiroj që dëshmitari të shpjegojë pasqyrën e transfertës së parave ku dëshmitari nënshkroi për NT Leotrimin në shumën 41,364.00 të datës 15 mars 2004 ku paratë shkonin në Jugopetrol Al Mali i zi.

....

G.V: Qind për qind unë isha autorizuar nga Ge për ta bërë këtë.

Prokurori publik: Ju pyeta nëse kishit autorizim në emër të NT Leotrimi?

G.V: Nuk isha i sigurt sepse kishte shumë kompani që duhej të më jepnin autorizim. Disa kompani e kanë bërë këtë dhe duket se Ge e bëri. Pa autorizim nga klienti nuk do ta kisha bërë këtë transfertë dhe as banka nuk do ta bënte.

....

Prokurori publik: Nuk po kundërshtojmë që banka nuk do ta lejonte këtë. Po ju pyes nëse kishit autorizim me shkrim nga G.R ose R.O?

G.V: E përsëris, kanë kaluar tetë vjet. Tani që e shoh mund të them se isha i autorizuar.

.... Prokurori publik: A do të thotë kjo se kishit lidhje të ngushtë me NT Leotrimi?

G.V: E kam thënë këtë në fillim.

Prokurori publik: Unë kam dokumente të tjera në emër të Ge që janë në shkresat e lëndës dhe më janë propozuar. Dua të merrem edhe me një dokument tjetër para se të vazhdoj më tutje. ... Kam një listë të bankës për bizneset dhe klienti është NT Leotrimi dhe emri i G.Vt përmendet shumë herë dhe data është 15 tetor 2008 dhe me lejen e gjyqtares dëshiroj ta konfirmojë klienti.

....

G.V: Po befasohem që përmendet viti 2008. Ju mund t'i shihni datat dhe ishte koha kur tarifat doganore më paguheshin mua.

....

Prokurori publik: Kuptuan se ishit autorizuar në emër të NT Leotrimi. A shkuat në Mal të Zi për të nënshkruar ndonjë kontratë në emër të NT Leotrimi ose NT Petrol-Nol në Cetinje?

Kryetarja e trupit gjykues: Po ose jo.

G.V: Nuk e mbaj mend, nuk e di. Mund të kem kryer cdo shërbim që më ka kërkuar pronari.

Prokurori publik: A e keni pyetur ndonjëherë G.Rn se cfarë kualifikimi kishte ai?

G.V: Jo, as atë as njeri tjetër. Kam vetëm parasysh se kushdo që merret me afarizëm e di.

Prokurori publik: Ju jeni ekonomist. A keni vënë re nëse G.R kishte shkathtësi për të menaxhuar një kompani?

....

G.V: Nuk isha aq i sigurt nëse ai ishte përgjegjës për menaxhimin si duhej të kompanisë.

....

Kryetarja e trupit gjykues: Kur e ndaluat biznesin me këta dy të pandehur?

G.V: Dikur nga viti 2004.

....

Rexhep Hasani: A kishit autorizim të përgjithshëm apo ndonjë konkret për rastin?

G.V: Fillimisht në vitet 2000-2002 nuk ishte nevoja e autorizimit me shkrim. Kjo lejohej nga dogana. Vozitësit vinin me dokumentacionin dhe ne regjistronim bazuar në të. Paguheshin tarifatat dhe shkonim; procedurë e thjeshtë. Gjithnjë kisha një autorizim të përgjithshëm dhe jo të vecantë. Ju mund ta konfirmoni këtë rast kur të vinë dy dëshmitarët e tjerë, domethënë, vëllai dhe bashkëshortja ime. Unë kam autorizim në terma të përgjithshëm.

Haxhi Millaku: Ato nuk bëjnë asgjë.

G.V: Kjo ishte marrëveshja jonë.

Rexhep Hasani: Me gruan dhe vëllain tuaj, a jeni pronar ju apo jeni bashkëpronarë?

G.V: Unë jam pronar i firmës Shkoza, gruaja ime e firmës Ngas dhe vëllai im i firmës Vegas. Unë kam përgatitur dokumentin specifik.

Rexhep Hasani: Kryetarja e trupit gjykues pyeti më parë kur dhe përse ju e ndaluat lidhjen me të pandehurit?

G.V: ... Mendoj se ishte 2004. ... Mund ta ketë ndaluar Ge këtë ose ndoshta ai nuk kishte para për mallrat, nuk e di.

Rexhep Hasani: A ishte G.R apo R.O që ju autorizuan?

G.V: Mendoj se ishte G.R për NT Leotrimi pasi ai ishte pronari.

Rexhep Hasani: Po kompania tjetër?

G.V: Unë nuk kisha autorizim dhe nuk kam bërë punë për këtë.

....

Kryetarja e trupit gjykues: A ju kujtohet nëse keni shkuar ndonjëherë në bankë me G.Rn për autorizim?

G.V: Po, megjithatë, nuk e mbaj mend datën.

....

Haxhi Millaku: A keni pranuar ndonjë pagesë përmes NT Leotrimi përmes bankës apo në para fizike?

G.V: Lidhur me NT Leotrimi kam pranuar para fizike por edhe nëpërmjet bankës.

....

G.R: Dëshmitari sapo deklaroi sot se nuk kishte punë me NT Petrol-Nol. Pra ai konfirmon sot se nuk kishte lidhje biznesi me këtë kompani të sapo-përmendur.

G.V: E saktë.

...

G.R: Z. G.V qëndroi me mua deri në vitin 2010. A kam punuar në kompaninë tuaj si vozitës?

G.V: Po, por pa kontratë. Megjithatë ju keni vozitur disa herë.

G.R: A ishim bashkë në Mal të Zi në Kompaninë Bonus dhe po i referohem NT Petrol-Nol?

G.V: Ju lutem përsëriteni pyetjen.

G.R: A ishim ne bashkë, unë dhe ju z. G.V në Mal të Zi në Kompaninë Bonus në Cetinje dhe në akomodim privat për të rregulluar një kontratë në Podgoricë në emër të NT Petrol-Nol?

G.V: Në asnjë mënyrë në akomodim ose pronë private. Është e mundur, megjithatë, në një zyrë por nuk më kujtohet.

Kryetarja e trupit gjykues: Pyetja ishte nëse ju ishit atje për NT Petrol-Nol?

G.V: Unë nuk kam shkuar në emër të dikujt, mund të kemi qenë bashkë.

....

G.R: Shuma e madhe e transferuar nga Peja, personat që morën transfertën në anën tjetër, a kanë ata dijeni për transfertën e parave? Dhe personat, nëse i morën paratë në anën tjetër, a e njohin G.Vn ose mua?

G.V: Me siguri ata nuk e njohin G.Vn. Për G.Rn jam i sigurt që po...

....

G.R: Përse kishit nevojë për pasqyrën bankare të NT Petrol-Nol në të cilën ishim bashkë në vitin 2007?

G.V: Unë nuk kisha nevojë për asgjë, lidhur me pasqyrën bankare, mund të kishte qenë kushdo prej partnerëve të tij ai që mund të kishte bërë kërkesë për të bërë qartësimin e biznesit. Sa për veten time, unë nuk kam dijeni lidhur me pasqyrën bankare sepse nuk kam nevojë për këtë. Për këtë nuk kisha autorizim me shkrim.

G.R: A isha unë, vëllai juaj F. dhe një person tjetër I. dhe persona të tjerë që dërgonin mallra kontrabandë në Mal të Zi ku kemi ngarkuar dhe shkarkuar mallrat e kontrabanduara.

G.V: Kjo nuk ka të bëjë fare me NT Petrol-Nol, as me rastin me të cilin po merremi sot. Kjo ishte punë e ligjshme për të cilën i kam të gjitha provat dhe dokumentet që do t'i paraqes kurdo të jetë e nevojshme në rastin konkret. Për këtë rast, i kam bërë një viitë Ali Rexhës dhe ia kam paraqitur rastin atje dhe nuk e di se çfarë ndodhi me rastin. Kjo ka të bëjë me aktivitetet e ligjshme të Kompanisë Shkoza, Ngas dhe Vegas. Për këtë jam përgjegjës.

G.R: A keni dijeni se unë kam shumë para kur uleni në zyrën tuaj? Po i referohem pagesës së doganës për mallrat e liruara. Unë nuk isha klient, unë i jepja dokumentacionin G.Vt dhe ai kishte klientët e tij dhe ai kishte lidhje pune me këtë klient, ai mund të ndërtonte edhe pasurinë e vet.

Kryetarja e trupit gjykues: Cila është pyetja tani?

G.R: G.V duhet të jetë i hapur dhe i sinqertë dhe të tregojë se ai më shfrytëzoi sepse ne jemi shokë dhe rrinim bashkë deri në ditën që u arrestova. Duke marrë parasysh se në atë kohë unë isha vetëm 22 vjeç dhe mund të mos i menaxhoja këto gjëra pa ndihmën e G.Vt. Për krahasim, cila është pasuria ime financiare kundrejt pasurisë së G.Vt jashtë kësaj kompanie. Nuk kam më pyetje, ai mund t'ju tregojë.

3. M.V

Dëshmitarja M.V deklaroi se është pronarja e Kompanisë NGaz Petrol. Por megjithëse ka studiuar për ekonomi dhe ka arsim të mesëm, ajo tha se nuk ishte fare në dijeni për kompaninë e saj, se ajo i besonte bashkëshorti të saj Ga i cili zhvillonte të gjitha aktivitetet e ndërmarrjes. Ajo nuk ishte e interesuar në administrimin e saj.

Ajo nuk mundi të shpjegojë përse i duheshin burrit të saj aq shumë kompani që merreshin me aktivitete të ngjashme. Ajo nuk ishte dëshmitare kyce sepse kryesosht deklaroi se nuk kishte ide lidhur me kompaninë e vet dhe se ishte bashkëshorti të saj Ga ai i cili punonte me kompaninë – i autorizuar prej saj.

4. F.V

Ai – i cili është fermer me arsim fillor – kishte një biznes me emrin “VeGas”. Nuk e administronte ai. Ishte vëllai i tij G.V ai që ishte autorizuar prej tij sepse i besonte.

Arsyeja sipas tij ishte se “ne e ndihmojmë njëri-tjetrin”. Për këtë “ndihmë” ai merrte para herë pas here nga Ga kur kishte nevojë, për shembull, për ndërtimin e shtëpisë së tij. Ai nuk kishte fare ide për kompaninë e tij dhe nuk i interesonte.

Proces-verbali i datës 24 tetor 2012 ka këtë përmbajtje:

Prokurori Publik: Megjithëse nuk keni dijeni për të dhënat e kompanisë, të paktën a e dini se me çfarë merrej kompania?

F.V: Nuk e di.

Prokurori Publik: Me çfarë merrej, benzinë, naftë apo çfarë?

F.V: Nuk e di, ai e di.

Prokurori Publik: Çfarë përfitimi kishit ju nga kompania?

F.V: Ai më ka dhënë njëfarë ndihme.

Prokurori Publik: A të jepte para?

F.V: Po, më ka ndihmuar në aspektin material për të ndërtuar një shtëpi.

Prokurori Publik: A të jepte para fizike euro?

F.V: Po, kur kisha nevojë.

Prokurori Publik: A i ka përmendur ndonjëherë R.On dhe G.Rn?

F.V: Jo.

Prokurori Publik: A e ka përmendur ndonjëherë kompaninë NT PETROL NOL dhe NT LEOTRIMI?

F.V: Jo.

Prokurori Publik: A ka thënë ndonjë gjë vëllai juaj për Ge ose një shleper industrial?

F.V: Automjete të rënda industriale.

Haxhi Millaku: A i dhe ti atij (Ga) autorizim për të tërhequr dhe për të depozituar para në xhirollogari?

F.V: Po.

Haxhi Millaku: A të njoftoi Ga ty si pronar i kompanisë për të gjitha transaksionet e biznesit?

F.V: Nuk e kam pyetur kurrë. Ai kishte autorizimin....

Gjykata është e mendimit se G.V përdori bashkëshorten dhe vëllain e tij për të hapur kompani dhe ta lejonin atë të administroheshin prej tij për përfitim të vet.

5. S.G

Ai deklaroi se është ekonomist me shkollë, shok i ngushtë i G.Vt që në ditët e tyre si studentë. Ai e kishte pasur biznesin e tij që në vitin 2002, të regjistruar për shërbime (mallra dhe doganë) dhe ndante të njëjtën zyrë me shokun e tij G.V – i cili merrej me importin e lëndës djegëse – në doganë, kur Ga nuk ishte atje, për të ndërmjetësuar me doganat në emër të tij. Ai e ndihmonte Ga mbi baza shoqërie veçanërisht nga viti 2005 e këtej. Ai ishte autorizuar nga Ga për transferta, tërheqje dhe depozitime të pagesave. Ai deklaroi se ishte autorizuar nga G.V të bënte pagesa. Ai kishte bërë edhe disa transferta për NT Leotrimi dhe NT Petro Nol diku. Ai deklaroi se nuk kishte dijeni për marrëdhëniet ndërmjet G.Vt dhe G.Rt.

Gjykata është e mendimit se asnjë prej këtyre tre deklaratave të M.Vt, F.Vt dhe S. Gt nuk i provoi akuzat e ngritura kundër të pandehurve. Gjykata pati përshtypjen se G.V i bëri këta dëshmitarë të ndihmonin në biznesin e tij – secilin sipas mundësive të tyre.

Provat me shkrim

Siç u cek më lart, u konsideruan si të lexuara.

Ato nuk përmbajnë ndonjë provë se të pandehurit i kanë kryer krimet që u vihen në barrë.

Të pandehurit

1. R.O

Ajo deklaroi se nuk e ka kryer asnjërin nga krimet me të cilat akuzohej. Ajo tha se nuk kishte hapur asnjëherë xhirollogari për “Leotrimin” dhe “Petro-Nol” dhe nuk kishte nënshkruar asgjë.

Ajo e kishte pasur gjithnjë me vete letër-njoftimin dhe nuk kishte vënë re ndonjë keqpërdorim.

Bashkëshorti i saj G.R i kishte dhënë para. Ai i kishte treguar asaj se punonte me një shok dhe në një kohë të caktuar, asaj nuk i kujtohej me saktësi, por disa vite më parë, Ge kishte punuar si vozitës për G.Vn.

Ajo nuk kishte pasur kurrë shumë para dhe nuk e kishte parë kurrë Ge me shuma më të mëdha se 150-200 euro. Ge dhe ajo ishin takuar dy herë me G.Vn dhe bashkëshorten e tij në një restorant, një herë në Prishtinë dhe një herë në Pejë. Në

kohën kur ishte me Ge dhe G.Vn dhe gruan e tij nuk u diskutua për biznesin. Kur Ge dhe R. u arrestuan, ajo mbante mend se ai zotëronte 500 euro.

2. G.R

Edhe ky deklaroi se nuk e ka kryer asnjërin nga krimet me të cilat akuzohej. Ai kishte punuar si vozitës kamioni vetëm për një kohë të shkurtër për G.Vn. Ai nuk ishte ndjerë asnjëherë kompetent për ta menaxhuar vetë biznesin sepse kishte vetëm 7 klasë shkollë arsimit fillor. Por ai e kishte lejuar G.Vn të hapte dhe administronte kompaninë e cekura sepse kishte shpresuar se do të mësonte prej tij dhe do të merrte diçka të vlefshme nga kjo marrëveshje, për shembull, punësim afatgjatë si vozitës. Por G.V i hapi kompaninë me kopje të letër-njoftimit të të pandehurit që ia dha G.R. Ga hapi xhirollogari dhe pas kësaj kohe ai i thoshte gjithnjë Ge kur e pyeste se kompaninë nuk kishin nxjerrë fitim dhe pas një farë kohe se ato nuk administroheshin më. I pandehuri i besoi Ga sepse ky është ekonomist i certifikuar. Ga përpilonte dokumentacionin dhe i pandehuri nuk kishte ide se çfarë po ndodhte prapa shpinës së tij. Proces-verbali i datës 6 dhjetor përmban ndër të tjera sa më poshtë:

G.R: Po, e tha këtë. Ai tha, "Do ta administroja kompaninë tënde si të ishe djali im, si dhe gruaja dhe vëllai im ose kompania ime." Ai administronte dy kompani nën emrin tim dhe me shumë gjasa administron një kompani në emër të një tjetri, i cili në të ardhmen mund të përfundojë si unë, në gjykatë.

... G.R: G.V lidhur me kompaninë nuk më jepte para sepse ai më tha, "Në këtë moment kompania nuk po bën ndonjë biznes. Në momentin që kompania pauzon mund vetëm të të jap para hua." Ai e bëri këtë në dy a tri raste, më dha 200 ose 300 euro dhe S.G ishte ai që m'i jepte paratë sepse G.V nuk më takonte personalisht. Ai ishte në Mal të Zi ose nuk e di se ku. ...Nuk e di nëse G.V e mbylli kompaninë apo e la të hapur. ... Prokurori Publik: Në rregull, për kompaninë tjetër Petrol-Nol, si u regjistrua ajo? G.R: Emrin e R.Ot. ...Ai mori vetëm fotokopje të dokumenteve dhe gjithë pjesën tjetër e plotësoi vetë. Prokurori Publik: A ia ke dhënë ndonjëherë dokumentin e R.Ot Ga? G.R: Po, dhe kur u hap kompania të gjitha dokumentet me vullë dhe të gjitha ato u mbajtën nga G.V. Prokurori Publik: A ke qenë me R.On në Ministrinë e Tregtisë për të hapur kompaninë? G.R: Nuk ishim. Prokurori Publik: A kishte kompania Petrol-Nol zyrë në Ferizaj? G.R: Jo. Kompania nuk kishte zyrë në Ferizaj. G.V e administronte këtë kompani nga Peja. Këto kompani ekzistojnë vetëm në letër. Ato nuk kanë subjekte ose ndonjë gjë ose nuk kanë lidhje me ndonjë pompë gazi. Ato nuk kanë asgjë. Ato ishin në letër dhe G.V i mbante ato letra me vete dhe i dërgonte ku dëshironte. Prokurori Publik: As në prizren, as në Ferizaj nuk kishte vend me logon e Petrol-Nol? G.R: Jo. Ato ishin vetëm kompani të hapura me letër nga G.V. ... Prokurori Publik:... Cili ishte objekti i biznesit i këtyre dy kompanive? G.R: Nuk e di se çfarë bënte G.V me ato dy kompani. G.V bënte tregti po se çfarë importonte ose eksportonte nuk e di, sepse nuk di as për vozitësit që sillnin mallrat apo gjëra. Ishte G.V ai që e përdorte këtë kompani dhe bënte tregti me të, jo unë. Jam i sigurt se nuk jam unë i vetmi që është përdorur nga G.V. Nëse mund të keni të tjerë si unë. ... Unë isha vetëm vozitës. ... Kryetarja e trupit gjykues: Ju na thatë se Ga mori fotokopje të letër-njoftimit të R.Ot dhe pastaj shkoi të hapte xhirollogari. Ju shkuat me të? G.R: Po. Kryetarja e trupit gjykues: Kurse R.O jo? A ishte ajo me ju? G.R: Për atë autorizim të veçantë të bërë në Ferizaj, po, ajo ishte dhe më autorizoi mua, por jo për xhirollogaritë e tjera të hapura për Leotrimin në Pejë. Petrol-Nol u bë në Ferizaj. G.V mori llogaritë rrjedhëse të bankës, edhe llogarinë për të cilën isha unë i autorizuar. Ai posedonte të gjithë dokumentacionin. Por ai nënshkrim konkret nuk është i imi. Ose ky formular është mbushur më vonë, nuk e di. Dikush e ka nënshkruar për mua, unë kështu

shkruaj. Ky nuk është shkrimi im i dorës dhe jo nënshkrimi im sepse në shkresat e lëndës keni dokumente që i kam nënshkruar unë. Mund ta krahasoni nënshkrimin aty me këtë këtu dhe me dorëshkrimin tim. Kryetarja e trupit gjykues: Këtë këtu ajo, R.O, e nënshkroi? G.R: Jo. Gruaja ime ishte me mua në bankë por ajo nuk e nënshkroi këtë. Trupi gjykues këqyr dokumentin. G.R: Jo, nuk e di. Gruaja ime nuk e ka nënshkruar këtë sepse gruaja ime nuk ka nënshkruar as dokumentacionin e martesës sonë. ... Kryetarja e trupit gjykues: Ju na treguat se ajo nënshkroi një autorizim. G.R: Po, ajo më autorizoi mua dhe e pranoi këtë, por ky nënshkrimi këtu nuk është i saj dhe për sa i takon autorizimit nuk është nevoja për shkresa, ajo më autorizoi mua. Ky nuk është nënshkrimi i saj. Është një autorizim i thjeshtë bankar. Ky është autorizim i bërë në bankë lidhur me pagesë. Nënshkrimet për transfertë e cekur në Aktakuzë dhe për depozitat e cekura në Aktakuzë nuk i kam bërë asnjërin prej tyre, as të depozitave as të transfertave. Këtë dua ta verifikoni ju dhe të shihni vetë se nuk kam fare qasje në transferua të mjeteve. Unë vetëm kisha hapur firmën. E kam autorizimin. G.V i mori të gjitha shkresat, krejt. Ai i posedonte vetë ato, i përdorte vetë dhe tani them se ai i përdori sepse unë jam këtu. ...

Gjykata është e mendimit se të dy të pandehurit treguan të vërtetën. Kjo mbështetet nga përshtypja lidhur me personalitetet e tyre: njerëz shumë të varfër, të thjeshtë, pa arsimim të mirë krahasuar me dëshmitarin G.V, i cili duket se është ekonomist dhe biznesmen i arsimuar mirë, i zgjuar, fakti që nënshkrimi në letërnjoftimin e R.Ot nuk është i njëjtë me atë të diskutuar në Shtojcën e Proces-verbalit të datës 6 dhjetor 2012, si dhe përshtypja që lanë deklaratat e dëshmitarëve G.V dhe bashkëshortes dhe vëllait të tij, siç u cek më lart.

Përfundim

Gjykata nuk mundi të zbulojë prova se ishin këta të pandehur ata të cilët i kryen veprat me të cilat janë akuzuar. Gjykata ndjek dëshminë e të pandehurës dhe është e mendimit se shënimet e saj personale në letërnjoftim u kopjuan dhe u përdorën pa dijeninë e saj për të hapur një llogari bankare dhe një kompani, megjithëse ajo donte t'i jepte autorizim bankar bashkëshortit të saj, ajo nuk nënshkroi asgjë dhe nënshkrimi i autorizimit për Casabank (Shtojca e Proces-verbalit të datës 6 dhjetor) nuk është e saj. G.R ia dha shënimet personale të letërnjoftimit të tij dhe të saj njërit prej dëshmitarëve të cilit i besonte dhe i cili duket se ka vënë në punë kompaninë pa kontrollin e tyre.

Vlerësimi ligjor

Të pandehurit G.R dhe R.O duhej të liroheshin nga të gjitha akuzat e Aktakuzës.

Kryetare e trupit gjykues

Gjyqtarja Annemarie Meister

Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtari Skënder Cocaj

Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtarja Teuta Krusha

Proces-mbajtëse

Vlora Johnston

Mjet ligjor:

Në bazë të nenit 400 të KPPK-së, palëve u lejohet të shpallin se do të paraqesin ankesë brenda 8 ditëve pas shqiptimit të Aktgjykimit. Palët kanë të drejtën të ushtrojnë ankesë kundër Aktgjykimit në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut Prizren brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita që u është dorëzuar kopja e Aktgjykimit, në bazë të nenit 398 paragrafi 1 të KPPK-së.